REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
1113/20
Datum: 25-01-2021
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.1113/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "AROMA PLUS" Shpk - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "MSS Mobile Sanitary Services" Shpk- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të jashtme dhe të brendshme të USHAF-it" me nr.prokurimi 20-5301-2-1-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"Ministria e Arsimit", më datën: 22.01.2021, mori këtë:

VENDIM

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "AROMA PLUS" Shpk - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të jashtme dhe të brendshme të USHAF-it" me nr. prokurimi 20-5301-2-1-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"Ministria e Arsimit".

II. ANULOHET, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të jashtme dhe të brendshme të USHAF-it" me nr.prokurimi 20-5301-2-1-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"Ministria e Arsimit", dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "AROMA PLUS" Shpk - Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "AROMA PLUS" Shpk - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt. 18.12.2020 me nr. 1113/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të jashtme dhe të brendshme të USHAF-it" me nr. prokurimi 20-5301-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"Ministria e Arsimit", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 10, 59, 60 dhe 61 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 18.12.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt. 29.12.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin 1

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "Aroma plus"Shpk & "Hightechevolution" Shpk se AK gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka rekomanduar për kontratë ofertën e OE "MSS Mobile Sanitary Services" Shpk, edhe pse ky OE nuk ka bërë kalkulimin e analizës financiare konform Ankesit 1 të specifikimeve teknike, konkretisht tek pozicioni i orëve të natës, ditëve të vikendit dhe festave zyrtare ka ofruar çmime paushalle që janë në kundërshtim me ligjin e punës dhe sipas grupit të OE ankues AK nuk ka bërë vlerësim të drejtë dhe korrekt të tenderëve konform nenit 59 të LPP-së, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në Aneksin 1 të sepcifikimeve teknike të detyrueshme ndër të tjera është kërkuar që OE duhet të angazhoj një mirëmbajtës për nxemje qendrore, ujësjellës dhe elektrikë me pagë mujore bruto prej 390.00 €,i cili duhet të siguroj kujdestari për intervenime emergjente gjatë 24 orëve.

Gjithashtu, në Aneksin 1 të dosjes së tenderit është specifikuar që OE duhet të paraqes analizë financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar në të cilën duhet të përfshihen pagat bruto për të gjithë punëtorët me të gjitha tatimet dhe kontributet, pagesa e ndërrimeve të natës për mirëmbajtësit, pushimet vjetore festave dhe detyrimeve tjera që dalin nga legjislacioni në fuqi dhe sipas specifikimeve të Aneksit 1 çdo çmim jo normalisht i ulët i vlerësuar sipas analizës financiare do të trajtohet si tender i papërgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm sepse OE i rekomanduar për kontratë për të dy pozicionet tek analiza financiare ka ofruar shuma paushalle duke mos ofruar asnjë analizë sesi ka ardhur deri te këto shuma paushalle.

Për pozicionin e orëve të natës tek analiza financiare OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar shumën prej 40.00 €, ndërsa për ditëve të vikendit nuk ka ofruar asnjë shumë.

Nëse kemi për bazë se në dosje të tenderit është kërkuar kujdestari 24 orëshe për mirëmbajtësit që paga e tij duhet të jetë 390.00 €, atëherë sipas një kalkulimi të thjeshtë nëse muajin e kalkulojmë me 30 ditë minimalisht duhet të ofrohej kjo shumë:

21.5 ditë të ndërrimeve të natës që sipas ligjit të punës duhet të paguhet +30% të pagës bazë

8.5 ditë të vikendeve/festave që sipas ligjit të punës duhet të paguhet +50% të pagës bazë

Paga bazë =390.00 € /176 orë në muaj = 2.22,orët e natës + 30%=2.22*30%=0.66 € shtesë për orë punë natën.

21.5 ditë të ndërrimit të natës x 8 orë = 172 orë x 0.66 € shtesë për orë të natës = 113.52 € x 5% kontributi pensional =119.20 €

8.5 ditë të vikendeve/festave x 8 orë =68 orë x 1.11 € çmimi për orë për vikend(2.22x50%=1.11) =75.48 € x 5% kontributi pensional = 79.25 €

Nga analiza e mësipërme rezulton që minimalisht për këto dy pozicione OE duhet të ofrojnë 198.45 € në muaj, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar vetëm 40.00 € për të dy pozicionet.

Gjithashtu edhe pretendimi tjetër i OE ankues lidhur me shumën e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë për pushimet vjetore ku është ofruar shuma prej 90.00 € për ekspertin shqyrtues është i pranueshëm sepse edhe për këtë pozicion nuk është ofruar ndonjë analizë sesi ka ardhur deri te kjo shumë. Nëse i kalkulojmë të gjitha pagat për të gjithë punëtorët:

- 6 punëtorë x 290.00 € = 1740.00 €
- 1 punëtorë x 300.00 € = 300.00 €
- 1 punëtorë x 390.00 € = 390.00 €
- 1 punëtorë x 400.00 € = 400.00 €

Totali =2,830.00 €

Bazuar në Ligjin e punës nr. 03/L-212,neni 32, punëtorit gjatë vitit i takon minimalisht 4 javë pushim vjetor që është rreth një muaj.

Nëse shumën totale të pagave e pjesëtojmë me 12 muaj atëherë 2,830.00 €/12 muaj = 235.83 €.

Shuma prej 235.83 € është shuma e përafërt mujore që duhet të planifikohet për pushime vjetore në ofertat e OE, shuma e OE të rekomanduar për kontratë prej 90.00 € nuk është as e përafërt më shumën e analizës së ekspertit shqyrtues, andaj pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Eksperti shqyrtues konstaton se AK nuk ka bërë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së dhe kërkesave të parashtruara në dosje të tenderit, andaj rekomandoj që lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK gjatë rivlerësimit duhet ti kushtoj kujdes kërkesave të dosjes së tenderit në mënyre specifike analizës financiare.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës me datën 29.12.2020.

Autoriteti kontraktues nuk ka përgjigje.

Operatori ekonomik me datë 30.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 22.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "Aroma plus" Shpk & "Hightechevolution" Shpk se AK gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka rekomanduar për kontratë ofertën e OE "MSS Mobile Sanitary Services" Shpk, edhe pse ky OE nuk ka bërë kalkulimin e analizës financiare konform Ankesit 1 të specifikimeve teknike, konkretisht tek pozicioni i orëve të natës, ditëve të vikendit dhe festave zyrtare ka

ofruar çmime paushalle që janë në kundërshtim me ligjin e punës dhe sipas grupit të OE ankues AK nuk ka bërë vlerësim të drejtë dhe korrekt të tenderëve konform nenit 59 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në Aneksin 1 të specifikimeve teknike të detyrueshme ndër të tjera është kërkuar që OE duhet të angazhoj një mirëmbajtës për nxemje qendrore, ujësjellës dhe elektrikë me pagë mujore bruto prej 390.00€, i cili duhet të siguroj kujdestari për intervenime emergjente gjatë 24 orëve. Gjithashtu, në Aneksin 1 të dosjes së tenderit është specifikuar që OE duhet të paraqes analizë financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar në të cilën duhet të përfshihen pagat bruto për të gjithë punëtorët me të gjitha tatimet dhe kontributet, pagesa e ndërrimeve të natës për mirëmbajtësit, pushimet vjetore festave dhe detyrimeve tjera që dalin nga legjislacioni në fuqi dhe sipas specifikimeve të Aneksit 1 çdo çmim jo normalisht i ulët i vlerësuar sipas analizës financiare do të trajtohet si tender i papërgjegjshëm.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm sepse OE i rekomanduar për kontratë për të dy pozicionet tek analiza financiare ka ofruar shuma paushalle duke mos ofruar asnjë analizë sesi ka ardhur deri te këto shuma paushalle.

Për pozicionin e orëve të natës tek analiza financiare, OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar shumën prej 40.00€, ndërsa për ditët e vikendit nuk ka ofruar asnjë shumë. Nëse kemi për bazë se në dosje të tenderit është kërkuar kujdestari 24 orëshe për mirëmbajtësit, ku paga e tij duhet të jetë 390.00€, atëherë sipas një kalkulimi të thjeshtë nëse muajin e kalkulojmë me 30 ditë minimalisht duhet të ofrohej kjo shumë: 21.5 ditë të ndërrimeve të natës që sipas ligjit të punës duhet të paguhet +30% të pagës bazë, 8.5 ditë të vikendeve/festave që sipas ligjit të punës duhet të paguhet +50% të pagës bazë, Paga bazë =390.00 € /176 orë në muaj = 2.22, orët e natës + 30%=2.22*30%=0.66 € shtesë për orë punë natën. 21.5 ditë të ndërrimit të natës x 8 orë = 172 orë x 0.66 € shtesë për orë të natës = 113.52 € x 5% kontributi pensional =119.20 €. 8.5 ditë të vikendeve/festave x 8 orë =68 orë x 1.11 € çmimi për orë për vikend(2.22x50%=1.11) =75.48 € x 5% kontributi pensional = 79.25 €.

Nga analiza e mësipërme rezulton që minimalisht për këto dy pozicione OE duhet të ofrojnë 198.45€ në muaj, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar vetëm 40.00 € për të dy pozicionet.

Gjithashtu edhe pretendimi tjetër i OE ankues lidhur me shumën e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë për pushimet vjetore ku është ofruar shuma prej 90.00€, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se edhe për këtë pozicion nuk është ofruar ndonjë analizë sesi ka ardhur deri te kjo shumë. Nëse i kalkulojmë të gjitha pagat për të gjithë punëtorët:

- 6 punëtorë x 290.00 € = 1740.00 €
- 1 punëtorë x 300.00 € = 300.00 €

- 1 punëtorë x 390.00 € = 390.00 €
- 1 punëtorë x 400.00 € = 400.00 €

Totali =2,830.00 €

Bazuar në Ligjin e punës nr. 03/L-212,neni 32, punëtorit gjatë vitit i takon minimalisht 4 javë pushim vjetor që është rreth një muaj.

Nëse shumën totale të pagave e pjesëtojmë me 12 muaj atëherë 2,830.00 €/12 muaj = 235.83 €.

Shuma prej 235.83 € është shuma e përafërt mujore që duhet të planifikohet për pushime vjetore në ofertat e OE, shuma e OE të rekomanduar për kontratë prej 90.00 € nuk është as e përafërt më shumën e analizës së lartcekur. Andaj, pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se AK nuk ka bërë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së dhe kërkesave të parashtruara në dosje të tenderit. Andaj, obligohet AK që gjatë rivlerësimit ti kushtoj kujdes kërkesave të dosjes së tenderit, në mënyre specifike analizës financiare, si dhe të bëjë vlerësimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "Ministria e Arsimit";

1x1 OE "AROMA PLUS" SH.P.K –Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.